

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 105/2017

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998,
“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 11, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Ministri përgjegjës për financat dhe ministri apo institucioni që ka në fushën e përgjegjësisë regjistrimin e pasurive të paluajtshme, përcaktojnë me udhëzim të përbashkët kushtet, procedurat dhe metodologjinë për zbatimin e këtij neni.”.

Neni 2

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime:

1. Pas shkronjës “f” shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:

“g) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”. Përjashtimi nga tatimi mbi fitimin, i parashikuar sipas këtij paragrafi, aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2024. Efektet e përjashtimit fillojnë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit special.”.

2. Në paragrafin e fundit, fjalët “deri në shkronjën “f”,” zëvendësohen me fjalët “deri në shkronjën “g”,”.

Neni 3

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28

Shkalla tatimore

1. Tatimi mbi fitimin është 15 %.
2. Për personat juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitet për prodhimin/zhvillimin e *software-ve*, tatimi mbi fitimin është 5 %. Këshilli i Ministrave përcakton, me vendim, aktivitetet që përfshihen në fushën e prodhimit/zhvillimit të *software-ve*, si dhe procedurat për zbatimin e këtij paragrafi.”.

Neni 4

Në nenin 38, pika 7, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Të ardhurat e organizatorëve të lojërave të fatit taten me tarifën tatimore mbi të ardhurat bruto, sipas kuptimit dhe përcaktimit në ligjet respektive të fushës, ligjit nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 95/2013 “Për miratimin e marrëveshjes së licencës për lotarinë kombëtare ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet i autorizuar, dhe shoqërisë “Oesterreichische Lotterien”, GmbH, nëpërmjet shoqërisë “OLG Project”, sh.p.k.””.

Neni 5

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2018.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 30.11.2017